



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 276/5 prot.

Tiranë më 28.3.2018

REKOMANDIM

Nr. 11, datë 28.3.2018

**PËR
KONTROLLUESIN SMARTCOM SH.A**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "SmartCom Sh.a".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.62, datë 12.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "SmartCom Sh.a", me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar dhe verifikimi i ligshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. "SmartCom Sh.a" është e licencuar nga AMF si një shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu ofron edhe shërbime marketingu për tituj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet telefonit dhe internetit. Në këtë kuadër ofron edhe asistencë për klientët të cilët sigurohen nga kompania "Rodeler Limited" (me qendër në Qipro), me të cilën ka nënshkruar një marrëveshje shërbimi. Klientët janë shtetas të huaj të cilët me vullnetin e tyre të lirë regjistrohen (dhe hedhin të dhëna personale) në platformën "24option.com" e cila është në pronësi të kompanisë "Rodeler Limited". "SmartCom Sh.a" në marrëdhënie me "Rodeler Limited" gëzon statusin e "përpunuesit" të të dhënave. "SmartCom Sh.a" nuk grumbullon të dhëna për klientët pasi përpunimi kryhet vetëm nëpërmjet platformës online www.24option.com.

“SmartCom Sh.a” ndërvepron me klientët përmes një platforme CRM (*Customer relationship management*) që administrohet nga “Rodeler Limited”. Aksesit është i kufizuar sipas llogarive të përdoruesve të kësaj platforme. Të dhënat e aksesueshme në platformë janë emri/mbiemri shtetësia dhe vendndodhja e klientit. Operatorët e “SmartCom Sh.a” telefonojnë klientët e regjistruar online në “24option.com” përmes *user_id/emrit* të klientit, por pa u njohur me numrin e kontaktit të klientit.

2. Në kuadër të verifikimit të dy ankesave të paraqitura nga z. (ish punonjës i “SmartCom Sh.a”), rezultoi se:

- Referuar ankesës mbi ekzistencën e kamerave në ambientet e tualeteve, pas aksesimit të sistemit të kamerave dhe kontrollit në vend, nga grupi i hetimit administrativ u konstatua se pretendimi nuk është i bazuar dhe i vërtetë.
- Referuar ankesës lidhur me mos aksesimin e “kontratës së punës” dhe “marrëveshjes së shërbimit” të nënshkruar midis ankuesit dhe shoqërisë “SmartCom Sh.a”, u konstatua se këto akte administroheshin dhe ruheshin në dosjen personale të ankuesit, në ambientet e zyrës së burimeve njerëzore. Nëpërmjet “marrëveshjes së shërbimit”, ankuesi në cilësinë e “ofruesit të shërbimit” merr përsipër me vullnetin e lirë të ofrojë shërbime të caktuara për shoqërinë “SmartCom Sh.a”.

Nga analizimi i provave të paraqitura nga ankuesi dhe dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi “SmartCom Sh.a”, nga njëra anë, nuk provohet që ankuesi të ketë kërkuar akses në të dhënat e tij personale të administruara nëpërmjet “kontratës së punës” dhe “marrëveshjes së shërbimit” dhe nga ana tjetër nuk provohet që kontrolluesi “SmartCom Sh.a” ti ketë vënë në dispozicion ose ti ketë ofruar mundësinë e vënies në dispozicion të këtyre akteve, gjatë marrëdhënies së punës dhe në momentin e shkëputjes së kësaj marrëdhënie.

3. Kontrolluesi “SmartCom Sh.a” nuk ka përcaktuar afate për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale të punonjësve dhe vizitorëve, në kundërshtim me nenin 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se, kontrolluesi ka përmbytur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi nuk ka përditësuar njoftimin, lidhur në përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “vizitorë” dhe për të dhënat biometrike (të shenjave të gishtave për punonjësit), konkretisht në rubrikat 3, 4, dhe 6 të Formularit të Njoftimit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 07.03.2018), si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 16.03.2018, përpara

marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ.

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga "SmartCom Sh.a" mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e këtij kontrolluesi për përmbushjen e detyrimeve ligjore, konkretisht:

- Hartimin e një klauzole në rregulloren e kompanisë, në të cilën, punonjësi firmos për marrjen në dorëzim të kopjes së kontratës së tij të punës apo marrëveshjes së shërbimit.
- Specifikimin e afatit për ruajtjen e të dhënave personale të vizitorëve në rregulloren e kompanisë.
- Paraqitjen e kopjes së formularit të njoftimit të datës 31.01.2017, dërguar pranë Zyrës së Komisionerit si deklaratë ndryshimi nr.1.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5/1/d, 21, 22, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "SmartCom Sh.a", në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përcaktimin dhe respektimin e afateve të veçanta për mbajtjen dhe përpunimin e kategorive të ndryshme të të dhënave personale, në përputhje me qëllimin për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunohen më tej.
2. Kontrolluesi "SmartCom Sh.a", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28/3/2018

